

Shoqata  
Mikrofinansca  
Shqiptare



Albanian  
Microfinance  
Association

2020

RAPORTI VJETOR I SHOQATËS

**MIKROFINANCA  
SHQIPTARE**

**2020**

## TABELA E PËRMBAJTJES

- 1 DY FJALË NGA PRESIDENTI
- 2 SEKTORI I MIKROFINANCËS DHE ZHVILLIMET E TIJ.
- 3 SEKSION I VEÇANTË - COVID-19
- 4 VEPRIMTARIA E ANËTARËVE TË SHMSH GJATË 2020
- 5 PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE GJATË 2020
- 6 EDUKIMI FINANCIAR
- 7 KËRKIME DHE PUBLIKIME
- 8 BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE
- 9 LOBIMI DHE ADVOKIMI



## DY FJALË NGA PRESIDENTI

Të nderuar lexues,

Është gjithmonë një kënaqësi momenti i ndarjes me ju të Raportit Vjetor të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, duke qënë se ky raport përmbledh qartazi punën e madhe të palodhur të institucioneve mikrofinanciare në Shqipëri gjatë për të sjellë gjithmonë shërbimin më të mirë dhe më të shpejtë tek të gjithë individët, fermerët dhe mikrondërmarrjet shqiptare në nevojë për financim.

Këtë vit, të gjithë ne ndihemi edhe më krenarë dhe të përlur ndaj të gjithë stafit të këtyre institucioneve, të cilët arritën që me profesionalizmin dhe punën e tyre të palodhur të kalonin një nga sfidat më të mëdha që bota, dhe sidomos sektori mikrofinanciar, kaloi gjatë vitit 2020.

Viti 2020 ishte një vit sfidues përtej imagjinatës për ekonominë shqiptare, jo vetëm si pasojë e ngadalësimit të ekonomisë botërore për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 dhe masave të marra për ta parandaluar atë, por edhe për shkak të rimëkëmbjes së ngadalë ekonomike pas rihapjes së lëvizjes së lirë në vend. Rritja e pasigurisë në lidhje me stabilitetin ekonomik, politik dhe social në vend ndikuan në uljen e konsumit në përgjithësi tek shtetasit shqiptar si edhe tek shprehitë e tyre të të harxhuarit para, si edhe reduktimin në masë të investimeve nga ana e sipërmarrësve

Për këto arsye rritja ekonomike e pritshme rezultoi në rënie, rreth -3.3% kundrejt 2% të vitit paraardhës. E megjithatë statistikave zyrtare të INSTAT për Produktin e Brendshëm Bruto dhe rritjen ekonomike gjatë vitit të shkuar 2020 tregojnë se goditja që ekonomia mori nga pandemia dhe recensionin i shkaktuar ishin në mënyrë domethënëse mjaft më të përmbajtura se sa pritshmëritë dhe shqetësimet fillestare.

Pavarësisht sfidave të paimagjinuara, sektori i mikrofinancës pati rezultate pozitive, dhe mori një rol vendimtar në ndihmën që i dha rigjallërimit të ekonomisë në sektorët që ajo përfaqëson si individë, fermerë apo biznese të vogla, të cilët nuk kanë akses në sistemin bankar.

Institucionet mikrofinanciare për vitin 2020 e rritën aktivitetin e tyre në krahasim me vitin me 2%, çka tregoi edhe një herë për ndihmën që institucionet mikrofinanciare i japin tregut sidomos në momente të thella krize.

Rezultatet e arritura pozitive pavarësisht periudhës së kaluar, nuk do të kishin qënë të mundura nëse ky sektor dhe aktorët e tij nuk do të kishin një bashkëpunim të ngushtë dhe një suport të menjëhershëm nga institucionet shtetërore rregullatore, siç janë Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Gjithashtu Qendra për Mikrofinancën e cila ka qënë një partner kyç në trajnimin e aktorëve të mikrofinancës në Shqipëri në lidhje me menaxhimin e situatave të krizës, me ndarjen e njohurive dhe rasteve të suksesit, me mbështetjen e saj në misionin e aktorëve të mikrofinancës për të rritur nivelin e edukimit financiar, ka ofruar suport me shumë vlerë përcjelljen e praktikave më të mira në menaxhimin e krizës dhe njohuri për sa i përket studimeve periodike të tregut të zhvilluara nga Shoqata Mikrofinanca Shqiptare.

Institucionet mikrofinanciare arritën të adaptoheshim më shpejt ndaj kushteve të reja të jetesës për shkak të investimeve të vazhdueshme në teknologjinë e informacionit dhe platformave të avancuara digjitale, të cilat janë të integruara tashmë në të gjitha hallkat operationale.

Pavarësisht vështirësive, anëtarët e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare qëndruan në kontakt dhe vijuan të punonin ngushtësisht me njëri-tjetrin për të vazhduar ndikimin e këtij sektori në ekonominë e vendit, në rritjen e edukimit financiar si dhe për të rritur edhe më tej digjitalizimin e këtij sektori, çka do të sjellë padyshim një rritje të cilësisë së shërbimit tek individët, fermerët apo bizneset e vogla, akses në financim dhe produkte të reja më të personalizuar për gjithësecilin.

Ky do të jetë dhe fokusi kryesor gjatë vitit 2021, një vit po ashtu sfidues për ta sjellë sektorin e mikrofinancës në shkëlqimin e merituar dhe sa më pranë individëve, fermerëve apo bizneseve të vogla të cilët kanë nevojë për financim të shpejtë dhe të aksesueshëm në kushtet kur ekonomia ka nisur rimëkëmbjen dhe klientët tanë janë në fazën e rimëkëmbjes nga një krizë e cila ende nuk ka kaluar.

**Arlinda Muja**

President – Albanian Microfinance Association

# 2 SEKTORI I MIKROFINANCËS DHE ZHVILLIMET E TIJ

Viti 2020 do mbahet mend si një vit i paprecedentë për goditjen që solli në jetën shëndetsore, sociale dhe ekonomike në Shqipëri e mbarë globin. Duke marrë në konsideratë kushtet e vështira me të cilat u përballën ekonomitë e shteteve, pa përjashtuar edhe ekonominë tonë, vlen të përmendet që në krahasim me sistemin bankar, kompanitë e sigurimeve ose aktorët e tregut të kapitalit, sektori i mikrofinancës u godit më tepër nga pandemia kryesisht si pasojë e goditjes së marrë nga bizneset e vogla, ndërmarrjet e vogla dhe individët e punësuar.

Ndërprerja e papritur e veprimtarisë së biznesit në vend dhe bllokimi masiv që zgjati gati tre muaj ngriu të ardhurat e mijëra e mijëra bizneseve dhe individëve, me kërkesën që u ul në nivele historike dhe ripagimet e pezulluara si rezultat i Moratoriumit të Kredive, nën nismën e Qeverisë shqiptare dhe Bankës së Shqipërisë.

Megjithatë, në gjysmën e dytë të vitit ekonomia shqiptare tregoi nota gjallëruese, dhe kjo u reflektua në rritjen e kërkesës për produktet mikrofinanciare, e shoqëruar më zgjerim të portofolit të kredisë dhe rifillim të aktiviteteve nga ana e segmenteve të tregut të synuar të

mikrofinancës. Duke pasur parasysh që periudha të cilës i referohet ky raport u karakterizua nga një ngadalësim ekonomik i dukshëm në gjysmën e parë të tij, kërkesa kosumatore dhe ajo e bizneseve për produkte të mikrofinancës ndoqi të njëjtën tendencë rënëse, e cila u korrigjua në gjysmën e dytë të vitit.

Gjatë vitit 2020, tregu financiar jo-bankar (subjektet financiare jo-banka të angazhuara në kredihënie dhe mikrokredi, dhe shoqëritë e kursim kreditit) kanë reflektuar një rritje të lehtë të portofolit të kredisë prej 3% ose në vlerë absolute rreth 1.1 miliardë lek<sup>1</sup>, e cila i atribuohet kryesisht kredihënies kundrejt veprimtarive të tjera si mikrokredia, faktoringu apo qiradhënia financiare. Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë së IFJB-ve mbahet nga subjektet e kredihënies dhe mikrokredisë (74%). Më pas renditet portofoli i subjekteve të qirasë financiare (25%) dhe portofoli i subjekteve faktoring (1%). Portofoli i kredisë së IFJB-ve arriti në 6% të totalit të kredisë së sistemit bankar, me një rritje prej 0.3 pikë përqindjeje krahasuar me vitin paraardhës.

Ndërkohë, e ndarë sipas natyrës së veprimtarisë kredituese, situata e portofolit të kredisë paraqitet si më poshtë:

Veprimtaria Financiare	2019	2020	Ndryshimi	%
Kredihënie	14.69	15.50	0.81	6%
Mikro-kredi	11.39	11.60	0.21	2%
Qira Financiare	8.85	9.00	0.15	2%
Faktoring	0.53	0.50	0.03	-6%
<b>Total Kredihënia</b>	<b>35.46</b>	<b>36.60</b>	<b>1.14</b>	<b>3%</b>
SHKK & Unione, Kredihënie	8.04	8.49	0.45	6%

në miliard lekë



Në lidhje me totalin e bilancit të IFJB-ve, në dhjetor 2020, ai arriti në 59.6 mld lekë, duke u rritur gjatë këtij viti me 1.5 mld lekë ose 3%. Aktivitetet e IFJB-ve arrijnë në 3.8% të totalit të aktiveve të sistemit bankar, me një rënie prej 0.1

pikë përqindjeje krahasuar me vitin paraardhës. Totali i bilancit të Shoqërive të Kursim Kreditit, për të njëjtën periudhë, arriti në vlerën e 11.6 mld lekë, me një rritje prej 0.64 mld lekësh ose 6% gjatë vitit<sup>2</sup>.

Gjatë vitit 2020, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare përbëhej nga 9 anëtarë, ndër të cilët 6 SBJF (Agrokredit, Agro & Social Fund, Crimson Finance Fund Albania, Fondi BESA, luteCredit Albania, Kredo Finance dhe NOA), si edhe dy SHKK (Fed Invest SHKK dhe UniFin SHKK), duke u zgjeruar me 2 anëtarë në krahasim me vitin paraardhës.

Institucionet anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare nuk e ndalën për asnjë moment

kreditimin e ekonomisë, pavarësisht kërkesës së reduktuar ndjeshëm në gjashtëmuajorin e parë të vitit. Megjithatë, kredia e re e akorduar nga institucionet anëtare të AMA rezultoi me një rënie prej 43% krahasuar me vitin 2019, duke kapur totalin e 15.38 miliardë lekë kundrejt totalit të kredisë së re prej 26.9 miliardë të vitit të kaluar. Sigurisht që kjo tendencë u reflektua edhe në numrin e kredive të disbursuara gjatë vitit 2020, i cili u pakësua me 38% krahasuar me vitin paraardhës (shiko grafikët ilustrues)




Sigurisht që rezultat i mënjëhershëm i reduktimit të vëllimeve të kredisë ishte dhe rritja modeste e portofolit të kredisë gjendje, i cili u rrit me vetëm 2% krahasuar me 37% rritje në vitin 2019. Edhe rritja e sipërhënuar prej 2% u mundësua kryesisht nga ristrukturimet masive të kredive gjatë fazës së parë të moratoriumit, të cilat kapën shifrën e afërsisht 9.3 miliardë lek (rreth 76 milionë EUR) dhe një numër prej rreth 39 mijë kredi të ristrukturuara.

Përsa i takon cilësisë së portofolit të kredisë, sipas


shifrave të raportuara nga anëtarët, gjatë vitit 2020 u reflektua një rritje e portofoleve në vonesë prej më shumë se 30 ditësh, indikator që qëndroi në vlerën e 13.23% për fundin e vitit 2020 kundrejt shifrës prej 12% për fundin e vitit 2019 (shifrat u referohen vetëm anëtarëve të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare). Sigurisht që duke marrë parasysh situatën e vështirë ekonomiko-sociale të vendit për shkak të pandemisë, institucionet anëtare kanë marrë masat përkatëse duke rritur nivelin e provigjonimit për kredite me probleme, kryesisht të financuara nga kapitali i vet :

(grafiku më poshtë për ilustrim):



Struktura e bilancit të institucioneve anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare ndryshoi gjatë vitit 2020, në favor të kapitalizimit më të lartë kundrejt financimeve dhe donacioneve, si edhe depozitave të SHKK-ve. Gjatë 2020 u reflektua

një rritje e ndjeshme në kapital (30% krahasuar me fundin e 2019) si një mjet për të përballuar probleme të pritshme me portofolin si rezultat i krizës së pandemisë (më poshtë grafikët ilustrues):



Aktualisht sektori paraqitet i mirëkapitalizuar dhe në gjendje të përballojë edhe humbjet e përlllogaritura sipas skenarëve konservativë, neutralë dhe optimistë të menaxhimit të rrezikut të kredisë. Këtë e dëshmojnë edhe indikatorët financiarë në vijimësi, ku shumica e institucioneve janë në përputhje me standartet rregullatore të aplikuara në normalitet.

Treguesit e kredive me probleme mbeten të stabilizuar, pa treguar ende ndonjë përkeqësim të dukshëm. Këtu përfshijmë edhe portofolet e ristrukturuara dhe kreditë e shtyra nën moratoriumin e kredive apo edhe me pas.

Megjithatë, të gjithë institucionet qëndrojnë të vetëdijshme që zgjatja në kohë e pandemisë përtej kufijve të pritshëm do të ketë efekt negativ në cilësinë e portofolit të kredisë, nën trysinë e rritjes së papunësisë dhe mbylljes së aktiviteteve private me karakter familjar.

Qoftë subjektet financiare jo-banka, ashtu edhe SHKK-të rezultojnë me rezultat financiar pozitiv (SFJB raportohen me rezultat financiar prej 2.33 mld lekësh, dhe SHKK-të me rezultatin financiar prej 293 milionë lekësh) pavarësisht goditjeve nga kriza dhe situatës së vështirë me likuiditetin që hasën disa prej tyre.

## FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

Institucionet anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare janë aktive në kreditimin e segmenteve të mikrondërmarrjeve, dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, fermerëve dhe agropërpunimit, si edhe nevojave të individëve për produkte të financimit konsumator. Sigurisht që kur vjen fjala tek përfshirja financiare, apo aksesit në financime, mikrofinanca i shërben atyre segmenteve të tregut që nuk kanë akses në sistemin bankar dhe nuk kanë burime alternative financimi. E parashtuar në këtë formë, veprimtaria e kreditimit nëpërmjet mikrofinancës ka në thelb misionin e saj social, që materializohet në kauza si zbutja e varfërisë, krijimi i vendeve të punës, ngushimi i hapësirave gjinore në siëpërmarrje dhe punësim, si edhe mbështetjen e aktiviteteve sipërmarrëse për ato individë dhe familje që nuk kanë burime të tjera të ardhurash.

Sipas Raportit Vjetor të Mbikqyrjes 2020 të Bankës së Shqipërisë, subjektet financiare jo-banka kredituan bizneset në masën 75% dhe individët në masën 25% të kredisë së re. Sigurisht vëllimet në adresë të biznesit favorizohen nga vlera më të mëdha të kredisë, ndërkohë që ato në favor të individëve mbizotërojnë në numër kredish. Sa i takon sektorëve të ekonomisë, ata me nivelin më të lartë të financimit në vitin 2020 janë "Aktivitete të tjera shërbimi" me 28%, "Tregtia, riparimi i automjeteve" me 19% dhe "Bujqësia" me 10%<sup>3</sup>. Për anëtarët e AMA, numri i fermerëve të kredituar në fund të vitit 2020 ishte 18,633 më një portofol kredie me tepriçë gjendje prej rreth 50.33 milion EUR, ose rreth 20% e portofolit gjendje në total.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka pasur një veprimtari intensive gjatë periudhës së pandemisë. Përveç aktiviteteve, publikimeve dhe eventeve në mbështetje të sektorit, gjatë vitit 2020 vëmendja u përqëndrua në sjelljen e sektorit në vëmendjen e politikëbërjes dhe përfshirjen e tij në masat që u morën nga qeveria dhe Banka e Shqipërisë në mbështetje të popullatës dhe biznesit, në mënyrë që këta të fundit të përballonin një krizë të paparashikuar të shkaktuar nga COVID-19.

Gjatë vitit 2020 u organizuan tre tavolina

diskutimi të grupeve të punës të krijuara për të mirëmenaxhuar krizën e shkaktuar nga COVID-19, si edhe gjetjen e burimeve të qëndrueshme të financimit për të menaxhuar vështirësitë me likuiditetin që erdhën si pasojë e moratoriumit të kredive dhe vonesave në ripagimet e tyre. Po ashtu, një seri uebinaresh i erdhën në ndihmë anëtarëve për të adresuar problematika të caktuara me provigjonimet apo për të parë oportunitete të reja në fushën e pagesave digjitale dhe bashkëpunimit me institucionet që i ofrojnë ato.

Po ashtu, në planin e edukimit financiar, edhe këtë vit, AMA u bë pjesë e fushatës ndërgjegjësuere "Huamarrje e Zgjuar", dhe apo ashtu reflektoi një pjesëmarrje aktive në Rrjetin Shqiptar për Edukimin Financiar, ku ofron një kontribut të vazhdueshëm për përmirësimin e nivelit të edukimit financiar në vend.

Megjithatë, mbetet shumë pët të bërë në këtë drejtim, jo vetëm për sa i takon rritjes së ndërgjegjësimin në lidhje me sektorin dhe sfidat e tij, por edhe me nivelin e mbështetjes që qeveria apo Banka e Shqipërisë duhet të ofrojnë për institucionet mikrofinanciare, duke i konsideruar këto të fundit si partnere në kanalizimin e fondeve tek segmentet e pashërbyera të tregut dhe individët që jetojnë pranë niveleve të varfërisë.

Edhe gjatë vitit 2021, shtyllat kryesore të veprimtarisë së Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare do përqëndrohen në promovimin e sektorit, arritjeve dhe sfidave të tij, advokimit dhe përfaqësimit kundrejt politikëbërësve, rregullatorëve dhe aktorëve të tjerë të tregut, rritjes së nivelit të edukimit dhe përfshirjes financiare, si edhe rritjes së kapaciteteve të aëntarëve dhe forcimit të bashkëpunimit mes tyre. Një përparësi e vecantë edhe këtë vit do vijojë t'i jepet misionit social të aktivitetit të mikrofinancës, ndikimit që ai ka në shoqëri nëpërmjet uljes së varfërisë dhe rritjes së punësimit, dhe gjatë këtij viti është planifikuar një studim i posacëm për të matur dhe vlerësuar këtë ndikim.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare është e vendosur për të arritur të gjitha qëllimet e saj gjatë vitit

2021 nëpërmjet aktiviteteve të shumta të planifikuara për këtë vit si: studime tregu për të treguar dhe kuptuar me tepër mbi rolin konkret që mikrofinanca ka në përmirësimin e cilësisë së jetës së individit, tryeza të ndryshme diskutimi dhe pjesëmarrje aktive me ndikim direkt në kuadrin

rregullator të mikrofinancës për të mundësuar më shumë akses në financim, si dhe trajnime për anëtarët e saj dhe punonjësit e tyre për të përshpejtuar digjitalizimin e shërbimeve mikrofinanciare, dhe për të krijuar edhe më tepër mundësi dhe fleksibilitet për qytetarët.

## 3.1. Ndikimi i krizës së shkaktuar nga Pandemia COVID-19 në institucionet e mikrofinancës dhe si u përball sektori me sfidat e kësaj krize

Institucionet e mikrofinancës u përballën me sfida të ndryshme gjatë periudhës së mbylljes dhe pas saj, qoftë në planin administrativ ashtu edhe në atë të drejtimit të biznesit. Megjithatë, shumica e këtyre sfidave u superuan me një menaxhim të kujdesshëm

të likuiditetit, mbajtjes së komunikimit të ngushtë me klientët dhe mbështetjen e tyre në këto kohë të vështira, si dhe punës së palodhur të stafit dhe drejtuesve për të siguruar vijimësinë e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve në të gjitha kanalet e mundshme.

### a) Sfida e likuiditetit

Gjatë periudhës së mbylljes, një pjesë e institucioneve anëtare raportuan vështirësi në lidhje me raportin e kërkuar të likuiditetit, sidomos në kuadrin e moratoriumit të kredive. Por këto vështirësi u kapërcyen, kryesisht si pasojë e negociatave me investitorët dhe gjithashtu edhe me mbështetjen e strukturave aksionere nëpërmjet injektiveve të kapitalit.

Por duhet theksuar që aksesin në burime të reja ose në shtesë të burimeve ekzistuese të financimit është bërë mjaft sfidues, qoftë nga sektori bankar, ashtu edhe nga investitorët të jashtëm, të cilët janë duke riparë strategjitë e tyre të investimit në këtë kohë me pasiguri të lartë.

### b) Sfida e kufizimit të shpenzimeve

SFJB-të më të ndikuara nga COVID-19 mbyllën një numër degësh perkohësisht ose përfundimisht. Në total gjatë vitit 2020 janë mbyllur 60 degë të institucioneve anëtare ose 20% e tyre. Gjithashtu pati shkurtime të perkohshme ose përfundimtare.

Pati rishikim të pagave në forme të perkohshme dhe janë ndaluar rritjet e pagave. Në total gjatë vitit 2020 numri i stafit është ulur me 53 punonjës ose 3%, ndërkohë që për 6-mujorin e parë të vitit kjo shifer ishte në nivelin e 17.5%.

### c) Produktet, procesi kredidhënës dhe kanalet e shpërndarjes

Gjatë periudhës së mbylljes, dhe më pas, një pjesë e institucioneve dizenjuan produkte kredie për t'ju përgjigjur situatës, me këste të ulëta fillimisht që më pas rriten progresivisht, ose më periudha pa pagesë principali.

proces sa më të shpejtë. Institucionet anëtare raportojnë se puna me klientët u modifikua, duke pasur parasysh që në kushte normale puna me klientët më shumë zhvillohet në ambjentet e tyre të biznesit. Vizitat u reduktuan vetëm për ato raste kur kjo ishte e pashmangshme, dhe nën masa të repta protokolle të sigurisë shëndetsore.

Por duhet thënë që kriteret e kreditimit u shtrënguan, ndërkohë që u vu re një rritje e përdorimit të platformave dixhitale, një trend i kuptueshëm duke pasur parasysh kushtet e distancimit fizik. Edhe përpara shpërthimit të pandemisë dhe karantinës që erdhi si pasojë e saj, sektori i mikrofinancës i pati vënë theks të veçantë digjitalizimit të procesit të kredidhënies në të gjitha stadet e tij, për të siguruar komoditet për klientët dhe një

Megjithatë, institucionet e mikrofinancës vijuan aktivitetin e tyre dhe inkurajuan klientët që të përdorin produktet dhe shërbimet e tyre. Në këtë fazë të vështirë për bizneset dhe individët, dera e mikrofinancës mbeti e hapur për të gjithë individët, bizneset dhe fermerët që patën nevojë për financime.

# 4 VEPRIMTARIA E ANËTARËVE TË SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE GJATË VITIT 2020



## 4.1. Agro & Social Fund shpk

Padyshim që viti që lamë pas ishte një vit plot sfida dhe vështirësi për të gjithë njerëzimin, në çdo aspekt, sidomos në atë ekonomik. Duke qëndruar përballë një situatë të pazakontë, ne mund të themi me vendosmëri që Agro & Social Fund arriti të menaxhonte më së miri aktivitetin e tij, duke bërë përpara në ndjekjen e misionit dhe objektivave të përcaktuara.

Stafi i Agro & Social Fund, i përbërë prej 67 personash, iu ka shërbyer më shumë se 2,788 klientëve me një portofol prej 767,886,472 ALL përgjatë vitit 2020. Krahasuar me vitin 2019, Agro & Social Fund pati një rritje prej 19.3% të portofolit në vlerë dhe një rritje prej 11.2% në numër kredish aktive. Gjithashtu, pavarësisht efekteve negative të pandemisë COVID-19, në fund të vitit arritëm të siguronim një rezultat financiar pozitiv.

Përgjatë vitit 2020 arritëm të përgatishim dhe të nxirrnim në treg, në kushte jo të zakonshme, dy produkte të reja, të cilat siguruan rreth 17% të portofolit të disbursuar (në numër kredish) dhe 12% të portofolit të disbursuar (në vlerë kredish), duke e çuar në 8 produkte, inventarin e produkteve në shërbim të klientelës.

Po ashtu, përgjatë vitit 2020 Agro & Social Fund iu bashkua, për të dytin vit rradhazi fushatës

“Huamarrje e zgjuar”, me qëllim vazhdimësinë në procesin e edukimit të klientëve tanë për të qënë të kujdesshëm dhe të tregohen të zgjuar gjatë marrjes së një kredie.

Agro & Social Fund përgjatë vitit 2020 arriti të përmbyllë një proces vlerësimi ndërkombëtar “Financial Rating” nga MICROFINANZA RATING (vlerësues ndërkombëtar i njohur nga Komisioni Evropian), duke siguruar një certifikatë konfirmuese për përmirësimin e operacioneve si dhe një instrument vetkontrolli dhe vetëpërsosjeje.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 arritëm të përmbyllim procesin e self-evaluation për marrjen e certifikimit të Code of Good Conduct, rezultatet e të cilit priten në muajt e parë të vitit 2021.

Eshtë më se e qartë që viti 2020 ishte i mbushur me vështirësi të paparashikuara dhe këto vështirësi u përthye në sfida, sidomos për institucionet mikrofinanciare. Gjatë 3-mujorit Mars – Prill - Maj, Agro & Social Fund arriti të disbursonte vetëm 30% të objektivit të projektuar, tregues ky që u arrit të përmirësohej përgjatë periudhës tjetër të vitit. Gjithashtu Agro & Social Fund pati mbi 700 klientë të moratuar, gjë e cila u përthye në mungesë arkëtimesh e për pasojë në mungesë të lëvrimit të cash-it për institucionin.

## Indikatorët financiarë, aktivet, portofoli i kredisë në vëllim dhe numër, rezultati financiar

- Administrimi dhe menaxhimi i Fondeve me përgjegjshmëri, transparencë dhe efektivitet në një vit të vështirë të një Pandemie Globale;
- Rritjen e volumit të kredive Aktive në Numer me **11,1%** dhe në vlerë me **19,3 %**, për vitin 2020.
- Rritjen e volumit të Disbursimit në Numer me **6,4%** dhe **1.7%** në Vlerë, për vitin 2020.
- Rritjen e volumit Kumulativ në Numer me **7,3%** dhe me **13,2%** në Vlerë, për vitin 2020.



## Prioritetet strategjike dhe objektivat për 2021

Për hartimin e strategjisë për vitin 2021 Agro&Social Fund ka realizuar një kërkim të kujdesshëm, duke vlerësuar situatën aktuale dhe zhvillimet e pritshme në ekonominë shqip-

tare dhe duke mbajtur në fokus objektivat afatshkutra, afatmesme dhe afatgjata të Institucionit dhe ndërveprimet me të gjithë aktorët.

### OBJEKTIVI STRATEGJIK:

Agro&Social Fund do të jetë i fokusuar në dhënien e kredive mikro dhe të vogla për bizneset apo të vetpunësuarit, si dhe kreditimin për qëllime të tjera në përputhje me misionin e organizatës, duke ruajtur statusin si "Institucion Financiar i Mikro-kredisë".

Agro&Social Fund gjithashtu do vazhdojë të synojë kontributin e shtuar në rritjen ekonomike, reduktimin e varfërisë së vendit apo përmirësimin e cilësisë së jetës të familjeve bujqësore, komuniteteve në nevojë në zonat rurale apo gjysmë-urbane nëpërmjet ofrimit të kredive të përshtatura sipas nevojave të tregut të synuar.

Agro & Social Fund përgjatë veprimtarisë së saj do të ketë në fokus elementë të rëndësishëm që lidhen me:

- Zgjerimin dhe afërsinë e shërbimeve për klientelën e synuar; duke projektuar hapjen e një dege të re ( Durrës);
- Studimin e tregut dhe nevojave të klientelës së synuar në vazhdimësi dhe shqyrtimin e mundësive për diversifikimin e mëtejshëm të produkteve të ofruara apo përshtatjen e tyre në përputhje me kontekstin ( pandemia covid-19, pasojat aktuale dhe të pritshme);
- Rritjen e treguesit të vetëmbajtjes financiare e me të njëjtin përkushtim ruajtjen dhe thellimin e dimensionit social. ASF beson fort se vetëm një institucion i qëndrueshëm financiarisht ka mundësinë e ruajtjes, zhvillimit dhe përmirësimit të misionit social;
- Shqyrtimin e perfeksionimit të praktikave aktuale që përdoren brenda organizatës në rritjen e sensibilitetit të çdo anëtarit stafi për ruajtjen dhe forcimin e dimensionit social të organizatës, përfshirjen direkte të tyre në sa më shumë projekte specifike dhe me impakt direkt në përmirësimin e problematikave lokale apo përmirësimin e standardeve të jetesës kryesisht përmes kreditimit;
- Politikat e punësimit dhe adresimit të problematikave të identifikuar në menaxhimin e burimeve njerëzore, duke marrë në konsideratë sugjerimet në raportin e MFR-së (shtator 2020) që lidhen me përmirësimin e treguesit të turnover-it dhe elementët e lidhur me të;
- Rritjen e përfshirjes financiare të grupeve të përjashtuara nga shërbimet financiare, që besojmë se ndihmohet për tu përmirësuar nga prioritizimi i kreditimit të zonave rurale apo gjysmë urbane dhe popullsive në to, nga fokusimi në grupe vulnerabile, stimulimi i vetëpunësimit, vendosja e grave apo të rinjve në top grupet e synuara. ASF-ja beson se përfshirja në financë, e cila në çdo rast përkthehet në përmirësimin e cilësisë së jetës së individëve kredimarrës, rrit shanset e përmirësimit të jetës së një zinxhiri individësh familjarë të tyre apo edhe komuniteteve;
- Të qenit aktorë dhe kontribues në rritjen e edukimit financiar të grupeve të synuara

Agro & Social Fund shpreson dhe është besimplotë që viti 2021 do të jetë viti i ripërtëritjes, i sfidave e partneriteteve të reja, i zgjerimit të aktiviteteve dhe përsosjes së shërbimeve financiare të ofruara dhe jo vetëm.



## 4.2 Crimson Finance Fund Albania (CFFA)

Si për të gjithë ekonominë e vendit tonë dhe aktorët e tregut financiar, viti 2020 ka qënë një vit i vështirë dhe sfidues për Crimson Finance Fund Albania (CFFA). Pandemia botërore e shkaktuar nga virusi COVID-19, ka impaktuar drejtëpërdrejtë aktivitetin e shumicës së klientëve tanë, dhe për pasojë ka krijuar një gjendje të jashtëzakonshme përsa i përket menaxhimit të pagesave.

Viti 2020 kërkoi një mobilizim të vecantë nga ana e punonjësve të stafit tonë për trajtimin e personalizuar të shtyrjes së pagesave për secilin nga klientët tanë, me qëllim mbështetjen e tyre përgjatë kësaj periudhe të vështirë. Në këtë kontekst, në përputhje me udhëzimet e Bankës së Shqipërisë, CFFA ka bërë të mundur trajtimin e 100% të kërkesave të klientëve për shtyje të afatit të pagesave deri në tre muaj, duke ristrukturuar kështu 55% të portofolit të saj. Kjo politikë rezultoi e suksesshme në tejkalimin e periudhës së vështirë të klientëve tanë, dhe rikthimin e tyre në ritmin normal të pagesave përgjatë gjysmës së dytë të vitit.

Pavarësisht vështirësive, viti 2020 ka shënuar

disa arritje të rëndësishme për CFFA. Me rritjen e kapitalit me afro 1 milion EUR (dhe 1 milion EUR të tjera përgjatë vitit 2021), CFFA ka përditësuar licencën e saj duke u bërë pjesë e tregut të kredihënies së përgjithshme përveç atij të qirasë financiare dhe factoring-ut.

Në vitin 2020, CFFA ka arritur të rrisë portofolin e saj me rreth 28% krahasuar me një vit më parë, si edhe të ulë me 3.5 pikë përqindje nivelin e kredive me probleme. Gjithashtu, për herë të parë qysh prej themelimit të saj, CFFA ka arritur të prezantojë një rezultat neto financiar pozitiv cka dëshmon një përmirësim të ndjeshëm në performancën e saj.

Në vitin 2021, CFFA synon të rrisë me 45% volumin e portofolit të saj krahasuar me vitin 2020, si edhe të përmirësojë cilësinë e tij në vazhdim duke ulur nën 6% nivelin e kredive me probleme. Përgjatë vitit 2021, CFFA synon të fokusohet më shumë në tregun e kredihënies, si një burim më i qëndrueshëm në arritjen e misionit të tij, atë të mbështetjes së bizneseve mikro dhe të vogla me akses të limituar në burime financiare.

## 4.3 FedInvest SHKK

FED invest është Shoqëria më e madhe e Kursim Kreditit në Shqipëri me një pervojë 29 vjecare, e shtrirë në mbarë territorin e vendit me 60 degë fizike dhe me kanale digjitale, në shërbim të anëtarësisë në zonat rurale dhe urbane, me një gamë të shumëllojshme shërbimesh financiare (kredi, depozita, pagesa utilitare etj) dhe jo-financiare (konsulencë, trajnime, edukim financiar, ekspertizë, rrjetëzim etj.).

Sfidat e Covid-19 me të cilat u përball FED invest këtë vit, ashtu si dhe ekonomitë, bizneset, familjet e institucionet financiare në mbarë botën, ishin të jashtëzakonshme. Falë përpjekjeve afatgjata në ndërtimin e themeleve të sigurta të qeverisjes institucionale, pozicionimin strategjik, ruajtjen e niveleve të larta të likuiditetit, kapitalizimit dhe cilësisë së aktiveve, FED invest arriti të reagojë shpejt dhe të përshtasë me sukses produkte e shërbime në ndihmë të anëtarësisë, ruajti ritmin e aktivitetit, duke operuar çdo ditë në të gjitha degët dhe forcuar më tej besimin e anëtarësisë. Investimet afatgjata në kapacitetet njerëzore, proceset dhe teknologjinë e re bankare, FlexCube, mundësuan realizimin me sukses të punës në distancë, duke kryer në kohë, me cilësi e siguri të lartë transaksionet për anëtarët.

Qasja dhe investimet e kryera gjatë viteve të

fundit në drejtim të digjitalizimit lehtësuan përbalimin e efekteve të pandemisë. Aktiviteti i FED invest gjatë vitit 2020 u fokusua në: respektimin me rigorozitet të protokolleve të sigurisë për parandalimin e përhapjes së virusit; zbatimin e sistemit të rotacionit dhe punës në distancë; në sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit e komunikimit me anëtarët edhe në ditët më të vështira; ristrukturimin e 10% të kredive aktive në një afat rekord prej dy muajsh në përputhje me kapacitetin e kredimarrësve; ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare dhe forcimin e marrëdhënieve me partnerët.

Pandemia përforcoi rolin që FED invest luan në nxitjen e përfshirjes financiare dhe instalimin në çdo qelizë të kulturës "Anëtari në Qendër". Mbështetur në projektin JICA dhe në aftësitë e reja digjitale, FED invest ngriti Qendrën e Asistencës Agri në Lushnjë, kombinuar me një platformë online interaktive – ABA online. Për të rritur aksesin në financë të segmenteve jashtë sistemit financiar dhe komunikimin me anëtarët ekzistues, u pilotua me sukses shërbimi i Internet Banking nga Oracle Digital Banking Experience. Në përgjigje të pasojave të shkaktuara nga COVID-19, në kuadrin e projektit FiAS, u zbatua Skema e Parë e Mbështetjes me Inpute Bujqësore për 250 fermerë të vegjël në nevojë.

## Indikatorët financiarë, aktivet, portofoli i kredisë në vëllim dhe numër, rezultati financiar

- **74,867** anëtarë;
- **60** degë dhe **254** të punësuar;
- Përfshirja e grave;
  - **35%** e anëtarëve;
  - **53%** e punonjësve;
  - **57%** e ekipit drejtues të lartë;
- **6.2 miliardë** Lekë totali i aktiveve dhe **6%** rritje për vitin 2020;
- **4.4 miliardë** Lekë depozita dhe **3.3%** rritje për vitin 2020;
- **89.9%** vlerësimi i kënaqësisë së punonjësve.

## PRIORITETET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT

Në përmbushje të misionit dhe biznes planit strategjik, në vitin 2021 FED invest synon ofrimin e disa prej shërbimeve të reja financiare dhe jo financiare për anëtarët:

- Shërbimi i pagesave utilitare në të gjitha degët e FED invest, sidomos në zonat rurale.
- Shërbimi i internet banking, FED Online, i aksesueshëm për të gjithë anëtarët në mbarë vendin.
- Platforma abonline.al dhe aplikacionet respektive për të gjithë telefonat smart, me një gamë të gjerë të shërbimeve jo-financiare do të ofrohen për të gjithë fermerët shqiptarë.

Krahas këtyre objektivave FED invest do të vazhdojë rritjen e kreditimit dhe depozitave, forcimin e markës, të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore, konsolidimin e pozicionit financiar dhe zgjerimin e partneriteteve strategjike.



## 4.4 Fondi BESA

Që nga fillimi i aktivitetit, Fondi Besa sha, në mënyrë të vazhdueshme ka qenë përkrah klientëve, në mbështetje të sipërmarrjes së vogël dhe të mesme si në zonat urbane ashtu edhe rurale, në të gjithë Shqipërinë.

Viti 2020, si një vit i veçantë dhe i pazakontë, në të cilin pasojat e tërmetit të vitit 2019 dhe pandemia Covid-19 na vunë përballë sfidave që shkonin përtej stabilitetit monetar dhe financiar, pati impaktin e vet edhe në aktivitetin e Fondit BESA. Pavarësisht vështirësive, institucioni duhet të vazhdonte shërbimet e tij, në mbështetje të biznesit të vogël dhe të mesëm, që ishte dhe mbetet sektori më i prekur nga kriza Covid 19.

Ajo që bëri menjëherë Fondi BESA, ishte të kuptonte situatën e klientëve dhe t'a përkthente atë në rreziqet që do të paraqiste për të gjithë veprimtarinë e institucionit. Bazuar në situatën individuale të çdo klienti, Fondi BESA mori vendimet më të përshtatshme, duke mbajtur parasysh shqetësimin për të mbështetur klientët dhe për të mos e ekspozuar institucionin në rreziqe të panevojshme. Ne pranuar masat e Bankës së Shqipërisë për të shtyrë dhe riplanifikuar huatë për biznesin që u ndikuan negativisht nga situata. Këto masa kanë shërbyer si një mbrojtje, duke minimizuar ndjeshëm rrezikun e përcjelljes së krizës nga sektori real në atë financiar dhe amplifikimin e mëtejshëm të saj.

Ndikimi më i madh negativ i kësaj situatë, do të ishte paaftësia e Fondit BESA për të vazhduar normalisht për të siguruar hua dhe financim për individët, bizneset dhe fermerët në nevojë për një periudhë kohe. Ne kemi provuar më të mirën për të vazhduar aktivitetin tonë, megjithë tkurrjen e ndjeshme të tij gjatë muajve të parë të pandemisë. Por në tremujorin e tretë dhe të katërt, aktiviteti ekonomik filloi të përmirësohej gradualisht, çka dha efektin e tij edhe në aktivitetin kredidhënës të Fondit Besa. Megjithatë, likuiditeti i kompanisë ishte në gjendje të menaxhonte çdo skenar të mundshëm. Kompan-

ia mbetet e mirëkapitalizuar për çdo situatë ekstreme.

Në fund të vitit 2020, Fondi Besa rezultoi me 82 zyra, duke siguruar mbulim të gjerë dhe të qëndrueshëm, ndërsa numri i punonjësve është rritur në 608, krahasuar me 576 në vitin 2019.

Rreth 30,000 klientë aktivë, mbi 13,000 kredi të dhëna gjatë vitit 2020 dhe rritja e portofolit të kredisë me 2.17%, duke arritur në mbi 13.5 miliardë lekë, janë tregues të qartë të përpjekjeve për t'i shërbyer një numri gjithnjë e më të madh klientësh, duke plotësuar nevojat e segmentit tonë të tregut për financim.

Me rreth 241 mijë kredi të dhëna gjithsej në shumën 89,1 miliardë lekë, Fondi Besa radhitet ndër institucionet që ka kontribuar në zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, krijimin e vendeve të punës si dhe përmirësimin e nivelit ekonomik, si rrjedhojë edhe atij arsimor dhe shëndetësor të mijëra familjeve si në zonat urbane ashtu edhe rurale në vend.

Në fund të vitit 2020, totali i asetëve të Fondit Besa rezultoi në 18.4 miliardë lekë, ndërsa Totali i kapitalit rezultoi 3,7 miliardë lekë.

Për sa i përket treguesve të përfitueshmërisë, në fund të vitit 2020, Fondi Besa krijoi një Kthim në Asete prej 2.22%, ndërsa Kthimi në Kapital ishte 11.77%. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të Fondit Besa në fund të vitit ishte 29.79%.

Paralelisht me zgjerimin e aktivitetit, Fondi Besa ka rritur edhe stafin e tij. Kjo ka kërkuar përpjekje të shtuara për rritjen e kapacitetit të tyre, duke synuar krijimin e një force pune të kualifikuar dhe të aftë për t'u përgjigjur të gjitha sfidave.

Gjatë vitit 2020, Fondi BESA vazhdon të jetë pronar 100% i aksioneve të Institucionit Mikrofinanciar "Social and Agro Fund".

Fondi BESA ka ndërtuar një bazë të fortë, e cila do të shërbejë për rritjen e metejshme të aktivitetit si përsa i përket zonës së mbulimit me shërbimet tona, zhvillimit të produkteve, ashtu edhe

zgjerimit të bazës së klientelës, duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e shërbimit për klientelën ekzistuese, ashtu edhe në thithjen e klientëve të rinj.

Tregues	Dhjetor 2020 (LEK)
Kredi Aktive	29,654
Portofol Kredie	13,514,530,289
Disbursime numër/vit	13,636
Disbursime vlerë/vit	7,014,433,208
Numri kumulativ i kredive	240,606
Shuma kumulative e disbursuar	89,070,347,332

## 4.5 IuteCredit Albania

IuteCredit Albania, licencuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë me licencën Nr. 32, datë 31.03.2015 si Institucion Financiar Jo-Bankar i Mikro-kredisë filloi veprimtarinë e saj duke ofruar kredi konsumatore në Prill 2015. Misioni i IuteCredit Albania sh.a. është të krijojë një përvojë të jashtëzakonshme në financat personale, duke tejkuluar pritshmëritë e klientëve. Qëllimi është përmirësimi i standartit të jetës të gjithsecilit, duke iu dhënë mundësinë të përdorin teknologji moderne dhe qasje në ekonominë dixhitale.

IuteCredit Albania ndihmon të gjithë klientët me produktet e kredisë, të cilat janë kredi konsumatore pa garanci, me maturitet nga 1 deri në 36 muaj. IuteCredit Albania ofron gjithashtu dhe kredi të garantuara me makinë me maturitet deri në 60 muaj. Shoqëria është pjesë e Grupit IuteCredit Europë AS me qendër në Estoni, e cila është e listuar në bursën e Frankfurtit, dhe që është aksioneri 100% i kapitalit të IuteCredit Albania.

Aktiviteti ekonomik në vend u prek nga situata e pandemisë globale për Covid-19 i shpallur në mëst të Marsit 2020 dhe si shkak i gjendjes së pandemisë, qeveria shqiptare mori një sërë vendimesh dhe masash kufizuese me synim përballimin e situatës. Masat shtrënguese për shkak të pandemisë Covid-19, vazhduan të jenë në fuqi edhe përgjatë 2021. Aktiviteti i shoqërisë IuteCredit Albania u ndikua negativisht kryesisht në tre tremujorët e parë të vitit 2020.

Totali i aktiveve të shoqërisë në 2020 pësuan një rënie me 7%. Fitimi i periudhës pësoi një rënie prej 5%. Mjete monetare pësuan një rënie prej 59% dhe numri i klientëve aktiv ra me 25 % krahasuar me të dhënat e një viti të mëparshëm. Numri i punonjësve në fund të vitit 2020 pati një rënie me 9% krahasuar me numrin e punonjësve në 2019. Kjo si rrjedhojë e pasigurisë që solli situatë e pandemisë në vend. Në tremujorin e fundit IUTE Credit Albania vijoi investimet në zhvillimin dhe përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të punonjësve të saj duke krijuar një

mjedis nxitës të zhvillimit përmes programeve të trajnimit.

Tremujori i fundit i vitit shënoi përmirësime në shumë tregues financiarë dhe në disa prej tyre patëm edhe rritje krahasuar me një vit më parë. Portofoli i kredisë në fund të 2020, edhe pas goditjeve të COVID-19, rezultoi me 4% rritje nga viti i kaluar. Kjo rritje u realizua në tremujorin e fundit të vitit si rrjedhojë e rritjes së kërkesës për kredi konsumatore. Cilësia e kredisë (CPI 30) në fund të 2020 pësoi një rënie shumë të lehtë, vetëm 2% më ulët se viti 2019. Jemi shumë krenar për klientët tanë të cilët kryen ripagimet e kësteve edhe atëherë kur lëvizja ishte e kufizuar vetëm me një ore në dite. Ruajtem nivelin e degëve që kishim në 2019 dhe u rritëm vetëm me një degë të re në tremujorin e fundit të 2020.

Edhe këtë vit, IuteCredit Albania vijoi përfshirjen në aktivitete me karakter dhurues. Në prill IuteCredit Albania dhuroi pajisje mjekësore për Spitalin Infektiv Tiranë, në ndihmë të pacientëve të infektuar me COVID-19. Monitoret e dhuruar tregonin paramentrat jetësorë të pacientëve të infektuar me COVID-19. Në një kohë shumë të shkurtër IuteCredit arriti të siguronte monitorët dhe t'i dorëzonte në Repartin e Reanimacionit të Spitalit Infektiv. Monitoret kishin një vlerë totale prej 5'000 € të cilat ishin sipas parametrave dhe standardeve të kërkuara nga vetë institucioni.

IuteCredit Albania i është bashkuar nismës së fondacionit "Fundjavë Ndryshe" për t'u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë në Bashkitë Durrës dhe Elbasan. 100 familjeve nga këto qytete u janë dorëzuar pako me ushqime për një muaj. Jane dhuruar mbi 2 tonë ushqime. Gjithashtu IuteCredit Albania iu bashkua nismës së Bashkisë së Tiranës "Adopto një gjysh/gjyshe", e cila synonte të mbështeste pensionistët që jetonin vetëm dhe nuk kishin njerez për t'u kujdesur për ta, duke adoptuar 50 gjyshër dhe gjyshe në Tiranë.

Përkrah faljeve në masë të penaltiteteve, rstruk-

turimeve të kredisë dhe shtyrjes së kësteve të kredisë gjatë dhe pas "Moratoriumit" të Bankës së Shqipërisë për të suportuar klientët të cilët kishin humbur punën dhe të ardhurat e tyre nga

pandemia, një kontribut i rëndësishëm i IuteCredit Albania ishte edhe solidarizimi në ndihmë të familjeve duke bërë faljen e kredive për jetët e humbura të klientëve nga COVID-19.

## PRITSHMËRITË PËR VITIN 2021

Me shpresën që vaksinimi për Covid-19 do të japë efekt mbrojtës tek gjithë popullata në vend dhe në botë, IuteCredit Albania ka disa pritshmëri për 2021 sikurse:

- 1) Zgjerimin e produkteve dhe shërbimeve për klientët tanë
- 2) Investime në Digitalizim
- 3) Vazhdimësi në rritjen e treguesve kryesorë financiarë;
- 4) Zgjerim i aktiviteteve në qytete të tjera të Shqipërisë

## 4.6 Kredo Financë

KREDO FINANCË si një kompani inovative FinTech, ashtu si dhe në ditën e parë të themelimit të saj, gjatë vitit 2020 arriti të ishte shumë e shpejtë në përshtatjen që kërkuan kohërat e reja ndaj klientit dhe operacioneve të përditshme.

Të përgatitur që në gjenezë, Kredo Finance ndërrmori jo vetëm ndryshimin e mënyrës së punës së përditshme por edhe edukimin e mëtejshëm të të gjithë bazës së saj të klientelës në shumë pak kohë. Kjo bëri që klientët tanë të ndjenin realisht se Kredo Finance është gjithmonë krahas tyre dhe një partner i vyer në kohë nevojë. Jemi shumë krenarë, për mënyrën se si u zbatua moratoriumi për të gjithë klientët tanë.

Pikërisht në momentin më delikat kur shumë prej tyre kishin humbur punët e pjesa tjetër jetonte me pasigurinë e humbjes së punës. Gjatë këtij procesi përveç ndalimit dhe faljes së penalteteve për të gjithë klientët janë ndihmuar me shtyrje të kësteve pa asnjë ngarkesë interesi apo tarife më tepër se 30 000 klientë, në mënyrë që anjëri prej tyre të mos ndihej i kërcënuar nga egërsia e situatës të cilën po përballonin.

Gjatë vitit 2020, numri i klientëve të procesuar për shtyrje të datës së pagesës, ndalime dhe falje të penalteteve si dhe ristrukturimit të kredive arrin në 30000 raste.

Shpejtësia e shërbimit dhe e kontaktimit të klientëve, ofertat konkurruese, ndihma gjatë pandemisë edhe më tej, transparencë, informimi, janë pika të forta të punës sonë dhe garanci e një marrëdhënie korrekte, transparente dhe efikase mes KREDO.al dhe qytetarëve.

Që në fillimet e saj, qëllimi i Kredo Finance ka qenë gjithmonë të sigurojë përfshirje financiare në tregun shqiptar duke ofruar kreditim të përgjegjshëm për klientët e saj me një shërbim të shkëlqyer ndaj klientit.

Në mënyrë që ti rikthehemi fazës së rritjes, të jemi në gjendje të zgjerojmë rrjetin e degëve, të

zgjerojmë gamën e produkteve dhe të zbatojmë procesin e dhënies së kredisë totalisht online në Shqipëri, ne kemi qenë në kërkim të një investitori strategjik për Shqipërinë që prej fillimit të vitit 2020. Tashmë, Kredo i është bashkuar familjes së investitorëve ndërkombëtarë - Mogo Finance Group!

Të qenit pjesë e Mogo Finance Group na sjell më afër arritjes së qëllimeve tona të biznesit, rritjes si dhe rifitimit e energjisë karakteristike të Kredo Finance në tregun vendas. Mogo Finance Group është një investitor strategjik i cili ka një histori të qëndrueshme në 17 vende në të gjithë botën, e cila krenohet me një shpërndarje të mençur të kapitalit, përfshirë këtu dhe blerjet fitimprurëse. Mogo Finance Group është një nga grupet më të mëdha evropiane të huadhënësve e orientuar drejt rritjes.

Kredo.al në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka konkretizuar gjatë vitit 2020 dhurimin drejt Spitalit të Infektivit i cilësuar si Spitali Covid 1 në drejtim të blerjes së medikamenteve dhe paisjeve mjekesore. Ky është hapi i fundit i misionit që Kredo Finance ka marrë përsipër gjatë muajit Dhjetor. Kredo Finance deklaroi se do të dhuronte 1 Lek për çdo 100 Lekë të dhënë kredi përgjatë gjithë muajit Dhjetor.

Kështu të gjithë klientët të cilët përfituan dhe nga ofertat e fundit të vitit kanë ndihmuar në luftën kundër koronavirusit. Gjatë vitit 2020 janë dhuruar gjithsej 20 000 Eur në drejtim të luftës ndaj Covid-19.

Viti 2020 ishte një vit sprovash, por ne ndihemi të fortë dhe të sigurtë në ecurinë tonë dhe vazhdojmë të kemi plane afatgjata dhe ambicioze për vitin 2021. Kredo Financë planifikon të vazhdojë zhvillimin e saj dhe kontributin e mëtejshëm në ekonominë e vendit. Ne do të vazhdojmë të përqendrohemi tek të gjithë ata që kanë më shumë nevojë për financim. Duke krijuar kështu jo vetëm mundësi financiare për shtresa, të cilat nuk shërbehen në institucione të tjera financiare, por

edhe duke i edukuar financiarisht këta individë duke i bërë ata të shërbyeshëm në një kohë shumë të shkurtër nga të gjitha institucionet financiare.

Në kuadër të transformimit të vazhdueshëm dixhital, ne do të vazhdojmë të jemi institucioni financiar jo bankë më i avancuar në vend, duke investuar në një platformë dixhitale për të sjellë funksionalitete të reja në mënyrë që t'i ofrojmë klientëve tanë zhvillimet më të fundit për ta bërë eksperiencën e tyre me këtë institucion sa më të lehtë dhe unike.

Në këtë kuadër ne do hedhim në treg platformën e re të aplikimit nëpërmjet internetit, e cila do të jetë 100% nëpërmjet internetit pa patur nevojë që klientët tanë të jenë prezent në degë. Gjithash-

tu do të vazhdojmë me misionin tonë për të rritur nivelin e Edukimit Financiar në të gjithë Shqipërinë, duke qenë se ne besojmë fortësisht se vetëm nëpërmjet të qënurit i edukuar financiarisht, një individ mund të marrë vendime të informuara dhe të drejta përsa i përket financave të tija si dhe të përmirësimit të sjelljes së tij ndaj kredimarrjes.

Asnjë plan, asnjë projekt, asnjë arritje nuk do të ishte e mundur pa punën e palodhur të të gjithë punonjësve tanë, prandaj planet për vitin 2021 përfshijnë dhe rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të punonjësve tanë nëpërmjet trajnimeve, përmirësimeve individuale si profesionale ashtu dhe ndërpersonale. Është kjo përkujdesje e vazhdueshme ndaj punonjësve tanë, që na bënë me plotë forcë një skuadër kompakte fituesish.

## PRITSHMËRITË PËR VITIN 2021

Kredo Finance beson fortësisht se kjo situatë do të na bëjë më të fortë dhe për këtë arsye për vitin 2021 planifikojmë:

- 1) Lancimin e Produkteve të reja
- 2) Lehtësimin e mëtejshëm të shërbimeve për klientët tanë
- 2) Hedhjen në treg të aplikimit online të plotë edhe për klientët e rinj.
- 3) Zgjerim të rrjetit të degëve;
- 4) Zgjerim i bashkëpunimeve me palë të treta për të ardhur edhe më pranë çdo klienti

### Treguesit financiar

Tregues	Dhjetor 2020 (LEK)
Rritje e Kapitalit nga 2019	70%
Zvogëlim i borxhit	-53 %
Volumi i kredisë së shitur gjatë 2020	1,946,870,405 All
Kliente të financuar gjatë 2020	57,252



## 4.7 NOA

NOA ka vijuar në çdo moment shërbimin ndaj nevojave të sipërmarrësve, fermerëve dhe familjeve shqiptare gjatë gjithë vitit 2020. Kjo është përmbledhja më e drejtë e asaj që bëmë gjatë vitit të shkuar. Ishte një sfidë për ekonominë e vendit, për çdo biznes e çdo familje. Një vit i mbushur me të papritura e të panjohura. Por

pavarësisht gjithçkaje, në respekt të misionit tonë themelues në shërbim të zhvillimit socio-ekonomik të vendit, NOA nuk i ndali në asnjë moment këshillimin dhe financimet e saj duke injektuar miliona euro për sipërmarrës të vegjël, fermerë e familje. Shifrat e 2020, e dëshmojnë më së miri këtë gjë:

- Disbursimet arritën **3.419** miliard Lekë dhe **11,350** financime gjatë 2020
- Rritja e portofolit aktiv arriti në **8%**
- **30%** e klientëve të financuar ishin sipërmarrëse femra dhe kryefamiljare

Situata makroekonomike e vuri në sprovë stabilitetin ekonomik dhe ekuilibrat delikatë të bizneseve të vogla familjare shqiptare. Duke operuar 7/7 dhe mos ndërprerë injektimet drejt ekonomisë së vendit, NOA arriti t'i mbështesë këto biznese në përputhje me filozofinë tonë të shërbimit "në çdo moment & në çdo kohë". Po kështu, në paralel, në mbështetje të atyre bizneseve apo fermerëve të cilët e patën më të vështirë përballjen me pasojat e frenimit të aktivitetit, NOA u angazhua në riskedulimin e rreth 2700 financimeve të impaktuara nga pandemia. Në mbyllje të vitit 2020 grupi i portofolit të klientëve të prekur përbënte rreth 20% të totalit, nga 29% që ka qënë në gjysmën e parë të vitit 2020. Kjo dëshmon sa e rëndësishme ka qënë në rimëkëmbjen e shpejtë mundësimi i një financimi fleksibël dhe të disponueshëm lehtësisht gjatë vitit 2020. Por viti që po lëmë pas ka patur dhe notat e tij pozitive. Bujqësia shqiptare dëshmoi se ishte një ndër sektorët më të qëndrueshëm në vend, edhe pse shumë fermerë u përballën me vështirësitë që rezultojnë nga mbyllja e eksporteve drejt tregjeve të huaja. Është në këtë kontekst që NOA financoi gjatë 2020 mbi 1200 fermerë me një total prej 674 milion Lekë, çka u përkthye në një rritje të

volumit të disbursimeve me 20% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë që në total portofoli i kredisë dedikuar sektorit të bujqësisë në NOA është përkthyer në rritje prej 6.5%.

Në rrafshin institucional, pavarësisht se situata e përgjithshme krijoi pasiguritë e veta, falë investimeve teknologjike të realizuara nga ekipet tona teknike, u mundësua me sukses një përshtatje shumë e shpejtë duke "transferuar" zyrën në shtëpi. Kjo mundësoi vijimin normal të aktivitetit në një kohë kur tregu financiar në terësi pësoi tkurrje dhe reduktim të vëndeve të punës. Në NOA asgjë prej këtyre nuk ndodhi, madje edhe pse në kushte krejt të reja me çdo operacion që rrotullohej rreth punës Online-it, në nivel kompanie, gjatë vitit 2020 u kryen 54 rekrutime të reja. Nga ana tjetër, nuk mund të mos evidentojmë faktin se segmenti më i prekur gjatë vitit 2020 ishin individët, një masë e konsiderueshme e popullsisë tejet e varur prej të ardhurave mujore nga aktiviteti profesional. Në përgjigje të nevojave të tyre, NOA mbështeti financiarisht mbi 8,200 individë, me një portofol financimi prej 944 milion Lekë të injektuara në buxhetin familjar shqiptar.

Pertej aktiviteti këshillues dhe financues, gjatë vitit 2020, NOA u investua në fushatën "Zgjidh/Zgjodha Shqipërinë", një fushatë kombëtare ndërgjegjësimi mbi sipërmarrjen e lirë, mbi bujqësinë dhe zgjedhjen e vendit tonë kundrejt alternativave të emigrimit. Pikërisht sepse ishte një vit pandemie, në këto momente më shumë se kurrë, NOA vendosi të ndikonte sadopak në rritjen e ndërgjegjësimit të çdo fermeri, sipërmarrësi apo

familjeje shqiptare mbi oportunitetet dhe të mirat e vendit tonë, alternativat dhe mundësitë që Shqipëria ofron, për të jetuar e zhvilluar çdo ambicje personale apo sipërmarrëse, këtu! Sepse siç thamë më lart, NOA nuk ka rreshtur në asnjë moment së shërbyeri nevojave të sipërmarrësve, fermerëve dhe familjeve shqiptare gjatë gjithë vitit 2020. Kjo është për ne arritja më e madhe.

### Treguesit kryesore të veprimitarisë:

Tregues	Dhjetor 2020 (LEK)
Kredi Aktive	12,928
Portofol Kredie	5,384,133,183
Disbursime numër/vit	11,350
Disbursime vlerë/vit	3,418,927,407

## 4.8 UniFin SHKK

Gjatë vitit 2020, UniFin ka vazhduar të ofrojë shërbime të plota financiare për anëtarët e saj, me profesionalizëm dhe përkushtim ndaj çdo anëtar, në përputhje me misionin tonë.

Si një vit i vecantë për mbarë botën pas shpalljes së situatës pandemike në Shqipëri në muajin Mars, fokusi ynë ishte qëndrimi sa më pranë anëtarëve për nevojat e tyre financiare dhe financimi i anëtarëve me aktivitete në sektorë të domosdoshëm, të cilët patën zhvillim gjatë pandemisë, siç janë blegtoaria e bujqësia,

përpunimi dhe tregtia ushqimore, transport mallrash ushqimor si dhe nevoja konsumatore për teknologji dhe transport ciklik. Filloi mbështetja për anëtarët me aktivitet të mbyllur ose të dëmtuar nga pandemia, duke krijuar mundësinë e shtyrjes së kesteve me një plan pagese të përshtatur me situatën e re financiare të tyre.

Njëkohësisht me plotësimin e kuadrit rregullativ, fokusi kryesor gjatë këtij viti ka qënë mirëmbajtja e protofolit aktual të kredive dhe niveli i qëndrueshëm i treguesit të kredisë në vonësë.

### Disa nga zhvillimet kryesore gjatë vitit 2020 ishin:

- U zhvillua dhe u implementua sistemi kompjuterik 042020 për shkëmbimin automatik të informacionit mbi llogaritë financiare të individëve dhe bizneseve,
- U hartua manuali dhe procedurat për shtyrjen e pagesave të kesteve të kredisë, sipas udhëzimeve të Bankës së Shqipërisë për t'u përshtatur situatës pandemike.

Për t'u përshtatur situatës pandemike tashmë prezente, u kryen studime të tregut ku UniFin kryen veprimtarinë dhe u bë kategorizimi i nevojave të anëtarëve sipas sektorit nga i cili burojnë të ardhurat e tyre mujore. Në këtë mënyrë u përshtatën dhe ripagimet mujore të kesteve të kredive, duke mbështetur anëtarët tanë për të qënë korrektë në historikun e tyre të kredisë. Ristrukturimet në portofolin e UniFin prekën kryesisht anëtarët të ardhurat e të cilëve buronin nga aktivitete të pezulluara për shkak të pandemisë. Periudha e shtyrjes së ripagimit u percaktua bazuar në rivlerësimin e situatës financiare dhe verifikimeve përkatëse të bera nga Dega dhe Departamenti i Administrimit të Rrezikut të Kredisë.

Në vijim të situatës pandemike, UniFin përshtati gjithashtu dhe metodologjinë e kredihënies gjatë financimeve të reja. Fokus ishte financimi i sektorëve të paprekur nga pandemia, dhe ata segmente tregu të cilëve u nevojitej kredia të përballonin nevojat e domosdoshme në veprimtarinë e tyre. Qëllimi kryesor i kësaj politike ishte mbështetja e klientëve në mënyrë që ata t'i ktheheshin aktivitetit të përditshëm.

Masat e nevojshme u morën dhe për riorganizimin e stafit dhe të kushteve të punës sipas udhëzimeve të Qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë.

### Të ashtuquajturat masat kundër Covid-19 konsistojnë në:

- Kalimi në gjendje pune online i 50% të stafit, duke mundësuar vetëm një person për çdo departament fizikisht në punë.
- U gjeneruan të gjitha lejet për qarkullim dhe veprimtari sipas instruksioneve të qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë.

- U morën masat për sigurimin e punës online dhe të kombinuar duke respektuar parimin e katër syve dhe duke minimizuar rrezikun operacional.
- U lejua aplikime dhe kërkesa digitale/online për kredi, nëpërmjet

udhëzimit të brendshëm të përpiluar në kuadër të situatës Covid-19. Formatu elektronik i aplikimeve, i thjeshtë dhe i qartë, u prezantua në faqen zyrtare të UniFin në internet, dhe u erdhi në ndihmë anëtarëve të plotësonin kërkesat e tyre.

### Indikatorët financiarë të UniFin per 2020

Tregues	Nr. i Kredive	Volumi
Kapitali		152,901,196.82
Totali i Aseteve		1,135,975,430.22
Portofoli i Depozitave	6,129	968,580,570
Portofoli i Kredise Bruto	2,246	869,841,172.41
Kredive të Disbursuara	1,253	626,273,880
Kredia Mesatare		469,357
Portofoli ne Risk (NPL)	5.69%	

Vlerat e tabelës në lekë

## PRIORITETET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT

Objektivi kryesor edhe për këtë vit do të jetë mirëmbajtja e portofolit dhe menaxhimi i portofoleve në vonësë. Në vijim do të vlerësojmë dhe hartojmë procesin e zhvillimit të produkteve të reja, bazuar në Vendimin Nr. 105, dt. 05/10/2016 të ndryshuar dhe ndryshesat përkatëse nga Mars 2020, si dhe për të plotësuar kërkesat e anëtarëve bazuar në objektivat e SHKK-së dhe udhëzimet e gjithë institucioneve mbikqyrëse. Bashkëpunimi i firmosur në Maj 2021 me German Sparkesensstiftung Albania do të vazhdojë për trajnimet e stafit dhe rishikimin e procedurave dhe manualeve të brendshme të ecurisë së përditshme të UniFin SHKK.

# 5 PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE GJATË VITIT 2020

## 5.1. Dita Europiane e Mikrofinancës 2020 – Konferenca vjetore e AMA



Shoqata Mikrofinanca Shqiptare organizoi në datën 25 nëntor 2020, një event virtual në formën e videoconferencës me temë: “Mikrofinanca Shqiptare në Normalitetin e Ri: Përballimi i Stuhisë”. Kjo Konferencë organizohet me rastin e Ditës Europiane të Mikrofinancës dhe aktivitetëve në mbarë kontinentin që organizohen për promovimin e mikrofinancës dhe rolit të saj si mbështetëse kryesore e shtresave në nevojë dhe mundësuese e përfshirjes sociale dhe financiare.

Në këtë event u diskutua në lidhje me çështjet e aktualitetit të sektorit, sfidave që ai ka hasur apo është duke hasur në ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve tek klientët, si edhe mundësitë dhe zgjidhjet që shfaqen në horizont për kapërcimin me sukses të këtyre sfidave. Mikrofinanca qëndron në shtyllën kurriore të shërbimeve financiare të ofruara për shtresat e shoqërisë në nevojë, prandaj duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që këtyre segmenteve t’u sigurohet qasje e qëndrueshme në financa.

Në këtë event ishin të ftuar si folës përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Autoriteti i

Mbikëqyrjes Financiare, Banka Botërore, Shoqata Shqiptare e Bankave, Bursa Shqiptare (ALSE), si edhe rrjetet ndërkombëtare të promovimit të financave sociale, si Qendra për Mikrofinancën (MFC), të cilët ndanë këndvështrime të vlefshme përse i takon rolit që mikrofinanca ka në mbështetjen e mijëra familjeve dhe mikrondërmarrjeve shqiptare për të siguruar vijimësinë e punës dhe të të ardhurave të tyre, si edhe mbështetjes që sektori i mikrofinancës duhet të marrë nga qeveria dhe aktorët kryesorë financiarë në vend për të realizuar me sukses misionin e tij.

Në përfundim të Konferencës, e cila u konsiderua një event mjaft konstruktiv, u nxorën përfundimet e mëposhtme:

- Sektori i mikrofinancës duket që tashmë e zotëron situatën, njëh pasojat dhe ka një plan të qartë për menaxhimin e krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19. Sektori ka synim kryesor të vijojë me mbështetjen dhe aksesin në financime të biznesit dhe familjeve, duke kontribuar më tej në përfshirjen financiare dhe ringritjen ekonomike të vendit;

- Roli i mikrofinancës në ekonominë e cdo vendi në zhvillim mbetet i qartë, sektori synon të arrijë në shkallë sa më të ndjeshme financimin e shtresave pa qasje të kollajtë për financim nga sistemi bankar, dhe është e rëndësishme të mbahet kjo ndarje e tregut, për të mundësuar tranzicionin e segmenteve të tregut me qasje të vështirë në segmente të trajtueshëm nga sektori bankar;
- Ekzistojnë disa alternativa për financimin e këtij sektori, të cilat ende nuk janë eksploruar dhe që do të shtonin vlerë nëse mundësohen si nga ana e instrumentave të qeverisë, ashtu dhe nga oferta publike, dhe pse jo të realizohet një bashkëpunim me sistemin bankar, për të qënë katalizatori për tregun që mikrofinanca shërben sot.

- Konfirmohet mbështetja nga Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore, që kanë qënë gjithmonë të hapur ndaj propozimeve të sektorit për kapërcimin e krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.
- Ka një interes të shtuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për tavolina bashkëpunimi me sektorin e Mikrofinancës në drejtime të ndryshme, të cilat do të shtojnë vlerë në shërbimet që kjo industri ofron, por dhe në nivelet e qasjes në financime, dhe në këtë kuadër do të vijojnë komunikimet konstruktive më tej.

Konferenca u ndoq me interes nga një masë e gjerë shikuesish, një pjesë e të cilëve morën gjallërisht pjesë në diskutime. Sesionet u transmetuan gjithashtu drejtpërdrejt në rrjetet sociale.



## 5.2. Tryeza diskutimi të Grupeve të Punës për çështjet kryesore të sektorit

Tryeza e parë virtuale, 27 prill 2020 - “Mikrofinanca shqiptare në kushte pandemie”




Në bashkëpunim me Microfinance Centre (MFC) dhe në kuadër të Programit të Komisionit Europian të Asistencës Teknike për Punësimin dhe Inovacionin (EaSI), Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

organizoi tryezën virtuale të diskutimit të Grupit të Punës “Mikrofinanca shqiptare në kushte pandemie”. Në këtë tryezë morën pjesë 27 përfaqësues në nivele drejtuese të institucioneve

të mikrofinancës, Anëtare të Shoqatës, të cilët ndanë eksperiencat e tyre dhe dhanë sugjerime të vlefshme në lidhje me masat e marra për të menaxhuar këtë situatë të vështirë, qoftë në

planin administrativ, ashtu edhe në atë të drejtimit financiar, sidomos në kushtet e mungesës së likuiditetit si rezultat i situatës në të cilën u ndodh ekonomia e vendit

## Tryeza e dytë virtuale, 28 shtator 2020 – “Mikrofinanca në realitetin e ri: Cilat janë alternativat?”



Shoqata Mikrofinanca Shqiptare, në bashkëpunim me Qendrën për Mikrofinancën (MFC) dhe më mbështetjen e Bashkimit Europian në kuadër të Programit për Punësimin dhe Inovacionin Social (EaSI), organizoi Mbledhjen e Dytë të Grupit të Punës për vitin 2020, me temën: Mikrofinanca në realitetin e ri: Cilat janë alternativat? Ky ishte një debat në lidhje me zgjidhjet për të kaluar sfidat në planin e zhvillimit të biznesit, operacional dhe menaxhimit financiar në institucionet e mikrofinancës në situatën e krijuar

nga pandemia COVID-19.

Të pranishmit ofruan eksperiencat e tyre institucionale në lidhje me ecurinë e biznesit, problematikat dhe zgjidhjet e përdorura për t'i adresuar ato, si edhe paraqitën propozime për periudhën në vijim, me qëllim sigurimin e vijueshmërisë së aktivitetit dhe garantimin e financimit për individët, bujqësinë, biznesin e vogël dhe të gjitha segmentet e synuara të tregut të mikrofinancës.

## Tryeza e tretë virtuale, 13 nëntor 2020 - “Sigurimi i burimeve të qëndrueshme të financimit për Institucionet e Mikrofinancës”



Shoqata Shqiptare e Mikrofinancave, në bashkëpunim me Microfinance Centre (MFC) dhe më mbështetjen e European Commission nën Programin e Punësimin dhe Inovacionit Social (EaSI), organizoi në 13 nëntor 2020, Takimin e Tretë të Grupit të Punës për vitin 2020, me temë: “Sigurimi i burimeve të qëndrueshme të financimit

it për IMF-të”. Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë për mikrofinancat dhe jo vetëm, në presionin e një pandemie të vazhdueshme dhe ndikimin që ajo ka pasur në mikro-bizneset, fermerët dhe familjet.

Për shkak të modelit të tyre specifik të biznesit,

IMF-të mbështeten shumë të financimi i jashtëm. Përveç SHKK-ve, të cilat sigurojnë rreth 11% të likuiditetit të tyre nga depozitat e anëtarëve, pjesa tjetër e IMF-ve i mbulon nevojat e tyre për likuiditet me fonde të veta dhe financime të jashtme. Të jesh në gjendje të sigurosh burime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të financimit po bëhet gjithnjë e më e vështirë, pasi Bankat lokale nuk ofrojnë linja financimi si më parë, dhe

institucionet ndërkombëtare kryesisht ofrojnë skema garancie për mbështetjen e segmenteve të ndryshme të tregut, por jo instrumente të drejtpërdrejta të financimit. Diskutimet në këtë takim të Grupit të Punës u përqendruan në mënyrën e qasjes ndaj investitorëve dhe institucioneve të financimit gjatë kësaj periudhe të vështirë, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e biznesit.

## Uebinar – Pagesat Digjitale dhe e ardhmja e tyre në Shqipëri



Me mbështetjen e Komisionit Evropian, përmes Asistencës Teknike të Programit EaSi, Qendra e Mikrofinancës dhe Shoqata Shqiptare e Mikrofinancave organizuan më 2.7.2020 një uebinar mbi pagesat dixhitale dhe të ardhmen e tyre në Shqipëri.

Çështjet e diskutuara kishin të bënin me kornizën e re legislative dhe rregullatore që po miratohet në vend sipas PSD2, çfarë do të thotë për Shqipërinë, si dhe përvojën aktuale dhe çfarë duhet të miratohet në drejtim të kornizës operationale dhe teknologjive të reja. Një çështje e rëndësishme në diskutime ishin përfitimet që kjo kornizë e re ligjore mund të sjellë për institucionet mikrofinanciare në lidhje me disbursimin e kredive dhe mbledhjen e ripagimeve të kredisë.

Uebinari u ndoq me mjaft interes, në kuptimin që përfaqësoi një nga ngjarjet më të rëndësishme në fushën e pagesave në Shqipëri për vitin 2020, me folës të spikatur si Znj. Ledia Bregu, Drejtore e Departamentit të Pagesave në Bankën e Shqipërisë, dhe znj. Linda Shomo, Drejtuese Ekzekutive e EasyPay, një nga pionierët e shërbimeve të pagesave elektronike në Vend.

Në fund pjesëmarrësit kontribuan me diskutime cilësore dhe këndvështrime në lidhje me temën e uebinit dhe implikimet që ai sjell në sektorin e mikrofinancës, aktualisht me një prezence mjaft aktive në Shqipëri për sa i përket klientëve të shërbyer dhe mbulimit të territorit.

## Uebinar – Përditësim i modeleve të humbjeve nga kreditë – AMA & PWC

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare, në bashkëpunim me ekipin e Pricewaterhousecoopers – PWC, organizuan uebinarin: “Përditësimi i modeleve ECL për shkak të COVID-19”. Jakub Černý, Ekspert i Lartë i Riskut në PËC, ndau njohuri dhe përvojë në lidhje me nevojën për të azhurnuar modelet e Humbjeve të Pritshme nga Kreditimi (Expected Credit Loss – ECL) për shkak të Covid-19.

Institucionet financiare në të gjithë botën po monitorojnë dhe po shqyrtojnë efektet e pandemisë COVID-19. Ata janë duke punuar për të kuptuar sfidat e menjëhershme të shoqërisë dhe

ekonomive dhe janë duke eksperimentuar për të ndihmuar veten e klientët e tyre për të marrë vendime të mira në mjedisin e sotëm. Në fund, e gjitha kjo është përkthyer në ndikime në raportimin financiar kryesisht në matjen e Humbjeve të Pritshme nga Kreditimi (ECL). Temat e diskutuara në uebinar ishin: skenarët ekonomikë dhe parametrat makro, ndikimi i pritshëm në modelet ECL dhe hapat e ardhshëm për të përditësuar modelet ECL. Sesioni u konsiderua mjaft i dobishëm dhe ofroi mbështetje dhe njohuri në trajtimin e modelimit të rrezikut dhe parashikimin e ndikimit të situatës aktuale në portofolet e huave të mikrofinancës.

# 6 EDUKIMI FINANCIAR

## 6.1. Fushata Huamarrje e Zgjuar 2020

Një ndër shtyllat kryesore të veprimtarisë së Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, edukimi financiar i masave ka marrë vazhdimisht rëndësinë e duhur nëpërmjet aktiviteteve, publikimeve dhe komunikimeve të shumta që Shoqata dhe anëtarët e saj organizojnë në formate të ndryshme. Këtë vit, AMA u bë pjesë e një komuni-

kimi shumë më masiv dhe interesant të edukimit financiar, sic ishte Fushata Edukative "Huamarrje e Zgjuar", një inisiativë e Qendrës për Mikrofinancën (MFC), një rrjet organizatash dhe institucioneve që promovojnë mikrofinancën sociale në 113 vende të botës.



Fushata "Huamarrje e Zgjuar" këtë vit u organizua në 14 shtete, me 26 institucione, shoqata dhe organizata pjesëmarrëse, të cilat kryesisht nëpërmjet kanaleve dixhitale për shkak të sigurisë shëndetësore, promovuan rëndësinë e edukimit financiar dhe marrjes së informacionit të detajuar gjatë procesit të aplikimit për një mikrokredi.

Disa nga aspektet e huamarrjes që theksohen nëpërmjet kësaj fushate kanë të bëjnë me përcjelljen e plotë dhe me fjalor të thjeshtë të informacionit bazë që shoqëron një kredi dhe procesin e huamarrjes, ndërgjegjesimin ndaj mbingarkesës me borxh financiar dhe se si mund të shmanget, njohja me të drejtat dhe detyrimet që i lindin huamarrësit me firmosjen e kontratës së kredisë, njohja e detajuar e të gjitha pikave të kontratës së kredisë, komunikimi me institucionet kredidhënëse nëse shfaqen probleme në ripagimin e kredive, etj.

Është shumë e rëndësishme që institucionet finan-

ciare dhe stafi që është në shërbim të drejtpërdrejtë të klientit, por edhe aktorë të tjerë të tregut financiar, të aplikojnë standarte maksimale të transparencës, etikës në ofrimin e shërbimeve dhe të shmangies së asimetrisë së informacionit, për t'i dhënë mundësinë klientit të marrë vendime të informuara dhe të bëjë zgjedhjen e duhur midis institucioneve të ndryshme dhe produkteve të ndryshme të të njëjtit institucion.

Përveç Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, këtë vit i janë bashkuar fushatës edhe anëtarët e saj: Agro & Social Fund, Fondi BESA dhe NOA, të cilët kanë qënë jashtëzakonisht aktive në komunikimin me klientët nëpërmjet rrjeteve sociale, prezantimeve, artikujve në media, uebinareve, panairëve dhe gjithë mundësive të tjera të komunikimit, për të dhënë një tablo sa më të qartë të informacionit që i duhet përcjellë klientit gjatë huamarrjes.

## 6.2. Pjesmarrja në Rrjetin Shqiptar për Edukimin Financiar

Edhe gjatë vitit 2020, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (AMA) mori pjesë aktivisht në aktivitete dhe takimet e Rrjetit Shqiptar për Edukimin Financiar, të cilat synojnë të koordinojnë

aktivitetet e institucioneve pjesëmarrëse me qëllim përmirësimin e nivelit të edukimit financiar në segmentet e synuara të tregut për cdo sektor.



Nga ana e Shoqatës është punuar jo vetëm nëpërmjet ndërgjegjesimit të institucioneve anëtare dhe rritjes së transparencës dhe cilësisë së këshillimit dhe shërbimeve të tjera jo-financiare të ofruara në sportelet e tyre, por edhe në drejtim të prezencës së vazhdueshme në media për të hedhur dritë mbi produktet dhe shërbimet

financiare dhe mënyrën se si t'i përdorim ato. Gjithashtu, Shoqata ka qënë aktive në organizimin e disa uebinareve me subjekt menaxhimin e financave personale, vlerësimin e nevojave financiare dhe detajet e aplikimit për kredi, kushtet e kontratës së huamarrjes dhe zbatimin e tyre, etj.



# 7 KËRKIME DHE PUBLIKIME

## 7.1. Studim mbi ndikimin e COVID – 19 tek Institucionet e Mikrofinancës



Shoqata Mikrofinanciare Shqiptare (AMA), kreu një Sondazh mbi ndikimin e COVID-19 në institucionet mikrofinanciare që veprojnë në Shqipëri. Anketa u krye gjatë periudhës qershor – korrik 2020, dhe përfshiu 8 anëtarë të AMA -s, përkatësisht: Agro & Social Fund, Crimson Finance Fund Shqipëri, FedInvest SHKK, Fondi BESA, IuteCredit Albania, Kreda Finance, NOA dhe UniFin SHKK.

Intervistat u kryen nga Sekretarja e Përgjithshme e AMA, znj. Brunilda Isaj, dhe kishin për qëllim vizatimin e një tabloje më të detajuar dhe materiale e industrisë së mikrofinancës duke përfshirë sfidat e përbashkëta, por edhe dallime të ndryshme brenda sektorit, pavarësisht organizimit, modelit të biznesit, biznesit,

madhësia dhe qasja e tregut.

Sondazhi kombinon informacion cilësor dhe sasior, dhe deri më tani është referenca më e afërt në formë dokumenti që pasqyron situatën e sektorit gjatë pandemisë. Megjithatë, informacioni dhe përfundimet e raportit i referohen periudhës kur është kryer sondazhi, dhe nuk paraqesin informacion të mëvonshëm në lidhje me situatën financiare të institucioneve të mikrofinancës, ndikimit të pandemisë në portofolet e kredive, një pjesë e mirë e të cilëve u ristrukturuan nën efektin e moratoriumit, si edhe situatën e likuiditetit dhe kërkesën në treg, të cilat në vijimësi reflektojnë qëndrueshmëri dhe problematikë më të kufizuar nga pritshmëritë në gjysmën e parë të vitit 2020.

## 7.2. Studim mbi “Digjitalizimi i shërbimeve mikrofinanciare”

Ky raport përmbledh gjetjet të studimit me tematikën – Digjitalizimi i shërbimeve të mikrofinancës. Studimi është zhvilluar gjatë muajit tetor 2020 dhe është shpërndarë në të gjithë aktorët e mikrofinancës pavarësisht shërbimit që ata ofrojnë, për të kuptuar të nevojën reale të digjital-

izimit të këtyre shërbimeve.

Në total kemi 9 aktorë të industrisë së mikrofinancës, dhe 270 klientë pra përdorues të këtyre shërbimeve, të cilët kanë shprehur opinionet e tyre në lidhje me temën e sondazhit. Rezultatet



zbulojnë se ka një dakordësi midis aktorëve se kriza e cila lamë pas është duke u zbehur në efektet që ajo ka patur tek këto kompani, dhe se pritet që periudha në vijim të jetë më pozitive edhe pse nën efektet edhe për ca kohë të kufizimeve që pandemia e Covid-19 ka sjellë në treg.

Gjatë kohës së pandemisë u vu re një nevojë e një niveli më të lartë për sisteme të digjitalizuara në shërbim të operacioneve dhe marrëdhënien dhe shërbimin me klientin. Shumica e kompanive kanë patur një nivel të pëlqyeshëm të digjitalizimit për të mos ndërprerë operacionet gjatë kësaj periudhe, por është parë një nevojë thelbësore

që klientët që këto kompani shërbejnë të kenë një njohuri më të mire përse i përket shërbimeve të digjitalizuara mikrofinanciare.

Midis kompanive të mikrofinancës ka një dakordësi që institucionet mikrofinanciare në përgjithësi posedojnë një teknologji më të lartë të informacionit të integruar në shërbimet dhe operacionet e tyre dhe do të jetë çështje kohe që dhe bankat të arrijnë këtë nivel teknologjik. Ndërkohë gjithashtu mendohet se industria e mikrofinancës ka ende potencial për të marrë treg dhe aktorët e kësaj industrie i shohin bankat si konkurrenca të fortë në ofrimin e shërbimeve në adresë të segmenteve të përbashkëta të klientëve.

## 8.1. Qendra për Mikrofinancën (MFC)



Microfinance Centre (MFC) – Qendra për Mikrofinancën, e vendosur në Varshavë, Poloni, është një rrjet që promovon financën sociale dhe përfshirjen financiare, dhe ka në përbërje të tij 113 ofrues të mikrofinancës, organizata jo-fitimprurëse dhe shoqata të institucioneve të mikrofinancës, si edhe entitete të tjera që janë të të vendosur në 36 shtete të globit dhe të përfshira në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare për shtresat në nevojë.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare është pjesë e MFC që prej vitit 2016, dhe një nga anëtarët më

aktivë në drejtim të aktiviteteve të përbashkëta dhe promovimit të financimit gjithëpërfshirës, etik dhe të përgjegjshëm. Gjatë vitit 2020, MFC ishte partneri kryesor i AMA në organizimin e një sërë veprimtarish për përballimin e krizës së shkaktuar nga COVID-19. AMA ishte pjesë e dy tryezave të diskutimit organizuar me rrjetet kombëtare të mikrofinancës me pjesëmarrjen e shteteve si Rumania, Bosnja Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Kosova, Azerbajxhani dhe Armenia, ku pjesëmarrësit ndanë eksperiencën e tyre me pandeminë dhe masat e marra në nivel kombëtar për përballimin e krizës.



Gjithashtu, gjatë vitit 2020, AMA mori pjesë në një seri uebinaresh me qëllim organizimin e përgjigjes korporative ndaj krizës, ku konsulentë dhe profesionistë të shquar të fushës së mikrofinancës ofruan eksperiencën, njohuritë dhe opinionet e tyre për të ndihmuar sadopak institucionet të krijojnë planet e tyre të rikuperimit të biznesit dhe të siguronin vijimësinë e tij.

MFC gjatë vitit 2020 mbështeti financiarisht në kuadër të programit të Bashkimit Europian për

Punësimin dhe Inovacionin Social (EaSI) tre tryeza diskutimi, një uebinar për pagesat digjitale dhe dy buletine lajmesh, të organizuara dhe publikuara nga Shoqata Mikrofinanca Shqiptare, të cilat ishin një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve përgjatë vitit. Gjithashtu, MFC ishte bashkëpunëtor dhe mbështetës e një studimi të dedikuar në ndikimin e pandemisë tek institucionet e mikrofinancës në Shqipëri, i cili u bë pjesë e një studimi në nivel europian, i publikuar nga MFC gjatë 2020.

## 9.1. Marrëdhëniet me Bankën e Shqipërisë

Institucionet Financiare jo-banka dhe Shoqëritë e Kursim Kreditit janë subjekte financiare që licencohen dhe mbikqyren nga Banka e Shqipërisë. Në kuadër të kësaj marrëdhënieje, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mban raporte të ngushta dhe bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë në drejtim të përfaqësimit të anëtarëve të shoqatës drejtim të përmirësimit dhe ndryshimeve të aplikuara në planin rregullator, si edhe informacionit cilësor dhe sasior të shkëmbyer në drejtim të ecurisë së sektorit dhe tendencave të vërejtura brenda tij në raport me ambientin ekonomik dhe financiar të vendit në përgjithësi.

Vlen të përmendet që bashkëpunimi i Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare me Bankën e Shqipërisë gjatë vitit 2020 ka qënë mjaft i ngushtë dhe cilësor, dhe se autoriteti rregullator ka treguar mirëkuptim në drejtim të sfidave me të cilat është

përballur sektori i mikrofinancës. Kjo u reflektua në dy momente kryesore gjatë krizës: së pari në mundësinë që iu dha institucioneve të mikrofinancës për të mos u bërë pjesë e moratoriumit të kredive në valën e dytë, si rezultat i vështirësive që ato po kalonin me likuiditetin, dhe në fleksibilitetin e treguar në krijimin e disa lehtësive rregulatore në drejtim të krijimit të provigjoneve dhe si rrjedhojë kërkesave për kapital shtesë në këtë proces.

Institucionet anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare mbeten të interesuara në këtë bashkëpunim dhe në përmirësimin e mëtejshëm të tij, si edhe në angazhimin e padiskutueshëm për të qënë në përputhje me kuadrin rregullator dhe kërkesat e autoritetit mbikqyrës në të mirë të zhvillimit të tregut të mikrofinancës dhe mbështetjes së familjeve dhe bizneseve me financim në vijimësi.

## 9.2 Marrëdhëniet me qeverinë dhe aktorët e tjerë të tregut financiar

Megjithë përpjekjet e vazhdueshme dhe intensive të Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancave dhe anëtarëve të saj, Qeveria nuk ka bërë shumë për të mbështetur sektorin e mikrofinancave. Ky sektor që për nga numri i klientëve të financuar e kalon 30% të totalit të klientëve që kanë marrë një kredi (përfshi edhe ata të kredituar nga sistemi bankar), mbështetet kryesisht nga fonde dhe programe rajonale me origjinë kryesisht vendet e Bashkimit Europian, dhe në drejtim të politikëbërjes nuk është pjesë e strategjive dhe iniciativave në nivel kombëtar

për mbështetjen e segmenteve me mundësi të kufizuara financiare, duke krijuar oportunitete për to sic janë iniciativat e vetpunësimit apo të krijimit të mikrondërmarrjeve.

Gjatë periudhës së mbylljes për shkak të pandemisë dhe masave të emergjencës që u morën në këtë drejtim, Qeveria, nuk e përfshiu sektorin e mikrofinancimit në asnjë nga Skemat e Garancisë Sovrane. Në situatën e vështirë që kaluam, Institucionet e Mikrofinancës nuk ishin as partnerë, as përfitues në këto skema.

### • Instrumentet qeveritare ose skema për mbështetjen e IMF-ve

Shumica e anëtarëve raportojnë se ata do ta vlerësonin ndihmën e çfarëdo lloji nga Qeveria, por propozimet e tyre përqendrohen në dy instrumente:

a) Qasja në likuiditet të menjëhershëm përmes financimit ose kredive me kushte të favorshme. Kjo nënkupton financimin e drejtpërdrejtë, borxhin e varur ose

instrumente të tjera të likuiditetit që sigurojnë para shtesë që shkojnë drejtpërdrejt në ekonomi përmes politikës së ndërmarrjes së rrezikut të nga institucionet e mikrofinancës.

- b) Skemat e Garancisë Sovrane dhe të ndarjes së rreziqeve, që përkundër faktit se ato nuk sigurojnë likuiditet të menjëhershëm, ato zvogëlojnë koston e financimit, dhe përfitimet i transmetohen konsumatorit përfundimtar, pra në ekonomi.
- c) Një qasje më e kuptueshme kundrejt standardeve rregullatore ndaj treguesve financiarë, të cilët kanë nevojë për kohë për tu rikthyer, veçanërisht në kushtet e një situatë pandemie afatgjatë.

Megjithatë, vlen të përmendet që marrëdhëniet me institucionet qeveritare janë përmirësuar në vijimësi. Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka

qënë pjesë e prezantimeve dhe diskutimeve në Këshillin Shqiptar të Investimeve dhe ka kontribuar në hartimin dhe komunikimin në vijimësi të politikave që i adresohen zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe qasjes së tyre në financime. Dialogu i nisur me institucionet dëshmon për një vullnet të mirë nga ana e tyre për ta përfshirë mikrofinancën në strategjitë e zhvillimit dhe skemat e mbështetjes së mikrondërmarrjeve, SME-ve dhe agrobiznesit si një faktor i rëndësishëm në kanalizimin e fondeve në ekonomi dhe krijimin e strukturave mbështetëse për zhvillimin e këtyre segmenteve.

Gjatë periudhës së mbylljes për shkak të pandemisë dhe masave të emergjencës që u morën në këtë drejtim, Qeveria, nuk e përfshiu sektorin e mikrofinancimit në asnjë nga Skemat e Garancisë Sovrane. Në situatën e vështirë që kaluam, Institucionet e Mikrofinancës nuk ishin as partnerë, as përfitues në këto skema.

<sup>5</sup>Shiko <https://www.investment.com.al>

